

REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA E KOSOVËS
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRE E DREJTËSISË
MINISTRE E DREJTËSISË
Nr. Be/No: 08-48/18/3
Data/Date: 10/04/2019
Shënim/Note/Annex: -6-



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/ Disiplinska Komisija/ The Disiplinary Comitee

Nr.3/2019

Komisioni Disiplinor për Përmbauesit Privat, në përbërje të Alajdin Tërshnjaku kryesues, Arton Fazliu dhe Fadil I. Hoxha anëtar, në çështjen juridiko-disiplinore ndaj përmbaueses private [redacted] si organ përmbaues, e emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, e dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 341 par.1, nënpar.1.1 dhe 1.2, dhe nenit 367 par.1, nënpar.1.1, 1.2, 1.7 dhe 1.10 të LPP, pas mbajtjes së seancave dëgjimore të dt:15.03.2019 dhe dt:03.04.2019, në të cilën seancë prezent kanë qenë: përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira Labinot Gashi, Udhëheqës i Divizionit për Jurisprudendë, Ndërmjetësim dhe Administrator Falimentues në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, pala ankuese [redacted] nga fshati Panorc i Komunës së Malishevës, i përfaqësuar sipas autorizimit nga [redacted] nga Prishtina, rr. "Nobert Jokël", Bll.B12, në mungesë të përmbauesja private [redacted] në cilësi të dyshuarës për shkelje disiplinore, e cila përmes komunikimit elektronik komisionin e ka njoftuar se nuk do të mer pjesë në seancë dëgjimore, në seancën e këshillimit dhe votimit të dt:03.04.2019 me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I.Përmbauesja private [redacted] si organ përmbaues, e emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, **është përgjegjës për shkelje disiplinore** nga neni 341 par.1, nënpar.1.1 dhe 1.2, dhe nenit 367 par.1, nënpar.1.1, 1.2, 1.7 dhe 1.10 të LPP, të përshkruar me propozimin për fillimin e procedurës disiplinore të dt:09.01.2019.

II.Për shkeljen disiplinore të kryer, përmbaueses private [redacted], e emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i shqiptohet masa disiplinore **gjobë në të holla në shumën prej 500.00€** bazuar në nenin 368 par.1, nënpar.1.3 të LPP.

III.Përmbauesja private [redacted] si organ përmbaues, **detyrohet** që gjobën në të holla në shumën prej në emër të masës disiplinore, t'a paguaj në llogari të buxhetit të Republikës së Kosovës, bazuar në par.3 të nenit 368 të LPP, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit, nën kërcënim të përmbaimit me detyrim.

Arsyetim

Ministria e Drejtësisë-Departamenti për Profesione të lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, me dt:09.01.2019 ka paraqitur propozim për fillimin e procedurës disiplinore, ndaj përmbarrueses private [redacted] e emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, si e dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 341 par.1, nënpar.1.1 dhe 1.2, dhe neni 367 par.1, nënpar.1.1, 1.2, 1.7 dhe 1.10 të LPP, për shkak se: përmbarruesja private si organ përmbarrues me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarrimore sa i përket lëndës P.nr.11/15, nuk ka zbatuar përmbarrimin sipas propozimit për përmbarrim të dt:02.02.2015, të paraqitur nga [redacted] si i autorizuar i kreditorit të përmbarrimit [redacted] nga fshati Panorë i Komunës së Malishevës, të lejuar me urdhër për përmbarrim P.nr.11/2015 në po të njëjtën ditë, në bazë të dokumentit përmbarrues-Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.115/2011.

Me qenë se përmbarruesja private nuk ka marrë pjesë në seancat dëgjimore të mbajtura me dt:15.03 dhe 03.04.2019 në hapsirat e Ministrisë së Drejtësisë, me ç'rast nga kryesuesi i komisionit para se përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë si propozues për fillimin e procedurës disiplinore të fillonte me shtjellimin e propozimit dhe provave, përmbarrueses private si organ përmbarrues në këtë çështje përmbarrimore, do t'i jepej mundësia e pranimit të përgjegjësisë disiplinore në zbatim të par.3 të neni 7 të UA.MD.nr.9/14 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbarruesit Privat, komisioni bazuar në përgjigjen e dhënë me shkrim nga përmbarruesja me dt:08.02.2019, ka vlerësuar se përmbarruesja private nuk e ndien vehten përgjegjëse për shkelje disiplinore dhe ka vazhduar më mbajtjen e seancës dëgjimore.

Komisioni, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, në seancën dëgjimore të mbajtur me dt:15.03.2019, si dhe në seancën dëgjimore të mbajtur me dt:03.04.2019, pas sigurimit të procesverbalit të dt:05.03.2018 nga vendi i ngjarjes në cilësi të provës, ka bërë shqyrtimin e provave përmes marrjes në pyetje në pajtim me nenin 7 par.5 të UA.MD.nr.09/2014.

Përmbarruesja private në përgjigjen me shkrim të dt:08.02.2018 ndaj propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj saj, ka deklaruar se: pala ankuese-kreditori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur propozim për përmbarrim në bazë të dokumentit përmbarrues aktgjykimit të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm, për çka i është lëshuar faturën nr.10029 e dt:02.02.2015. Meqenëse brenda afatit ligjor nga debitori nuk është ushtruar prapësim ndaj urdhërit për përmbarrim, kam vazhduar ndërmarrjen e veprimeve përmbarrimore me bllokim të llogarive, prokurim të pasurive, dalje në teren, për të cilat veprime kam lëshuar faturë për shpenzime procedurale, të cilat nuk i ka paguar kreditorit me arsyetimin "ju duhet t'i merrni prej debitorit". Përmbarruesja ka sqaruar se, me ratin e daljes në teren në vend të ngjarjes paraqitet [redacted] babai i ish bashkëshortes së debitorit [redacted] i cili bën një pagesë me pershkrimin për shpenzime të përmbarruesit P.nr.11/2015, dhe kërkon urgjent të largohemi nga banesa e vajzës së tij, nga e cila pagesë nga përmbarruesja janë ndaluar shpenzimet e procedurës në pajtim me nenin 13 të LPP dhe UA.MD.nr.6/14 dhe, pjesa e mbetur i është transferuar përfaqësuesit të kreditorit. Në vazhdim të përgjigjes me shkrim ka sqaruar se, pasi që kreditori nuk i ka paguar shpenzimet procedurale paraprakisht sipas neni 13 të LPP, kemi ardhë në përfundim që procedura në këtë çështje përmbarrimore duhet të përfundohet, në mënyre që të ketë një afat më të gjatë të mendoj për veprimet e mëtutjeshme dhe pagesën eventuale të shpenzimeve

procedurale, në mënyrë që të vazhdojmë menjëherë me procedurën. Tutje ka shtuar se, të gjitha veprimet përmbartimore në drejtim të zbatimit të përmbartimit në këtë çështje përmbartimore i kam ndërmarrë në harmoni me ligjet pozitive, gjegjësisht me nenin 341 të LPP, UA.MD.nr.6/14 dhe, autorizimet të cilat më janë deleguar nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës. Ka konsideruar se nuk kryer shkelje disiplinore as ligjore, komisionit i ka propozuar që pretendimet e palës ankuese ti refuzoj si të pabazuara, për shkak se kreditori-pala ankuese ka kërkuar ndërmarrjen e veprimeve të imponueshme dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Përfaqësuesi nga Ministria e Drejtësisë, në të dyja seancat dëgjimore të datave si më lart ka deklaruar se, propozimin për fillimin e procedurës përmbartimore e kemi paraqitur në bazë të ankesës dhe provave të ofruara nga pala ankuese, për shkak se përmbartuesja private si organ përmbartues nuk e ka zbatuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit për përmbartim të dt:02.02.2015, me këtë rast përmbartuesja ka bërë shkelje të nenit 341 par.2, nënpar.1.1 dhe 1.2 të LPP. Pastaj, përmbartuesja nuk i është përmbartje procesverbalit të vendit të ngjarjes të dt:05.03.2018, me të cilin procesverbal konstatohet se vjehri i debitorit, është pajtuar t'a paguaj borxhin kryesor në shumën prej 530.00€ ndërsa, shumën prej 329.40€ në emër të shpenzimeve të procedurës do t'a paguaj brenda dhjetë ditëve, kjo pasi që në procesverbal ka pas ndërhyrje pas nënshkrimit të tij, e që kjo nuk është etike e as ligjore sepse, është dashtë të bëhet një shënim zyrtar ose një shkresë tjetër e jo të ndërhyhet në procesverbal. Përfaqësuesi i propozimit, ka deklaruar se përmbartuesja procedurën në këtë çështje të përmbartimit, e ka pezulluar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP, e me të cilat janë parapa mënyrat dhe rrethanat e pezullimit të procedurës sipas detyrës zyrtare ndërsa, konkluzioni me të cilin përmbartuesja e ka pezulluar procedurën nuk ndërlidhet me asnjërën prej këtyre rasteve dhe se, pezullimi ka qenë i kundërligjshëm. Tutje ka deklaruar se, përmbartuesja ka bërë shkelje të nenit 341 par.1, nënpar.1.7, me të cilin janë përcaktuar detyrat e përmbartuesit privat të kryejë regjistrimin, vlerësimin e pronës, sekuestrimin dhe shitjen e pasurisë së luajtshme dhe të drejtave mbi pasurnë e paluajtshme, e kjo ndërlidhet me procesverbalin ku thuhet nëse nuk paguhet pjesa tjetër e borxhit vazhdohet me sekuestrim, ka kërkuar nga komisioni që përmbartueses si organ përmbartues t'i shqiptohet masë disiplinore ashtu siç e parasheh ligji dhe siç është propozuar në propozim për fillimin e procedurës disiplinore.

Si në seancën dëgjimore të dt:15.03.2019, ashtu edhe në atë të dt:03.04.2019, i autorizuari i palës ankuese-kreditorit të përmbartimit ka deklaruar se, në ankesë në detaje e kemi përshkruar krejt rrjedhën e procedurës, fatkeqësisht njihemi me përmbartuesen sepse kemi punuar bashkë, i kam thënë se nuk kështu dhe do të bëj ankesë sepse, as nuk du me ja marë as me ja lënë askujt asnjë cent, ka sqaruar se pas shumë përpjekjeve e kemi gjete adresën e debitorit, pastaj kemi dalë në teren së bashku me policinë, ku në vendngjarje kemi takuar vjehrin e debitorit, me ç'rast kur i kam parë fëmijët e vogël jam ndjerë keq dhe me pas ditë s'kisha shku as ato me i kërku hiq, kam pranuar që të më paguhet vetëm borxhi kryesor në shumën prej 530.00€ ndërsa, nga interesi kam hekë dorë, për çka është përpiluar një procesverbal për marrëveshjen që kemi arritur me vjerrin e debitorit dhe, jemi pajtuar që për pjesën e shpenzimeve ti dërgohet faturë e veqant për t'i paguar edhe ato vjehri i debitorit, e nënshkruajtem procesverbalin kopjen e të cilit sma ka dhënë sepse e ka mbartje për vete. Pasi e kam parë se në llogarinë time kanë dalë vetëm 200.00€, e pyeta përmbartuesen pse kështu, tha kështu jemi marrë vesh, unë i thash po a morëm vesh që me ja dërguar faturën për shpenzimet vjehrit të debitorit, pastaj unë kam kërkuar që me lënë krejt këtë lëndë dhe me ja kthye të hollat vjehrit të debitorit por, përmbartuesja tha edhe nëse ja falë prap duhet me i pagua shpenzimet dhe duhet me nisë lëndën prej fillimit, për çka kam konsideruar se nuk është në rregull dhe kam ushtruar ankesë. Gabimi im është që e kam dërgua tek përmbartuesi

sepse, këta bëjnë veprime me i rrit taksat e me përfitue për vete. Pas krejt kësaj ka ardhe një zyrtar i përmbaueses me një konkluzion dhe, më ka thënë vetëm duhet me nënshkru. Unë kam kërkuar nga ai djalë që para se me nënshkru duhet t'a lexoj, kur e kam lexuar "për tërheqje të lëndës, me nis edhe njëherë s'di çka" dhe, nuk e kam nënshkruar konkluzionin e dt:29.06.2018 me të cilin përmbauesja e ka pezulluar procedurën sespe nuk du me nënshkru diçka që nuk është kështu nuk jemi marrë vesh kështu, unë nuk kam lyp me tërheq lëndën por, me vazhdu siç u morëm vesh me vjehrrin e debitorit, përmbauesja e ka pezulluar lëndën njëanshëm pa pëlqimin tim. Pastaj, përmbauesja për me mbulua hapësirën e vet ligjore për shkeljet që i ka bërë, më ka dërguar një email të cilit i ka bashkëngjitur konkluzionin për pezullim të procedurës P.nr.11/2015, të cilin unë kam refuzuar t'a pranoj personalisht.

Komisioni, pas shqyrtimit të provave përmes leximit dhe marrjes në pyetje dhe, të gjitha shkresave që gjenden në dosjen e këtij rasti disiplinor, ka konstatuar këtë gjendje faktike: kreditori i përbarimit me dt:02.02.2015 tek përmbauesja ka paraqitur propozimin për përbarim në bazë të dokumentit të përmbaues-Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.155 /11 të dt:13.02.2014. Në të njëjtën datë përmbauesja me urdhërin P.nr.11/15 e ka caktuar përbarimin në këtë çështje përbarimore, me urdhërin P.nr.11/15 të dt:02.02.2015 dhe, pasi që ndaj tij nuk është ushtruar prapësim dhe i njëjti është bërë i formës së prerë, ka vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve përbarimore si mjete të përbarimit në drejtim të zbatimit të përbarimit në këtë çështje përbarimore, me ç'rast me dt:05.03.2018, me ndihmën e Policisë së Kosovës, ka dalë në teren me qëllim që në vend të bëhet regjistrimi dhe sekuestrimi i sendeve të debitorit por, në orën dhjetë (10:00) vend të ngjarjes është paraqitur [redacted] vjehri i debitorit [redacted] i cili ka pranuar që nëse kreditori i përbarimit heqë dorë nga interesi, t'a paguaj borxhin kryesor në shumën prej 530.00€, ndërsa për shpenzimet e procedurës t'i dërgohet faturë e veqant brenda dhjetë (10) ditëve për t'i paguar edhe ato.

Me nenin 10 par.1 të LPP është paraparë se: "Gjykata me aktvendim, ose përmbauesi privat me urdhër për përbarim, e cakton përbarimin ndaj atyre mjeteve dhe në ato objekte të përbarimit që janë specifikuar në propozimin për përbarimin" ndërsa, me par.2 të njëjtit nen është paraparë se: "Përbarimi përfshinë një apo të gjitha mjetet dhe objektet e përbarimit të paraqitura në propozimin për përbarim gjersa kërkesa të realizohet plotësisht"

Me nenin 13 par.1 të LPP është paraparë se: "Shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përbarimit paraprakisht i paguan kreditori" ndërsa, me par. 2 të njëjtit nen është paraparë se: "Shpenzimet nga paragrafi 1. i këtij neni, propozuesi i përbarimit ka për detyrë t'i parapaguaj brenda afatit të caktuar nga organi përmbaues. Organi përmbaues do ta pezulloj përbarimin po qe se nuk parapaguhet shpenzimet brenda afatit të tillë. Po qe se brenda afatit të dhënë nga organi përmbaues nuk parapaguhet shpenzimet për kryerjen e një veprimi konkret, atëherë nuk do të kryhet vetëm veprimi i tillë".

Me nenin 4 par.1 të UA.MD.nr.06/14 është rregulluar se: "Tarifat për administrimin e lëndës të parapara në Tabelën 1 si dhe tarifat për veprimet e ndërmarrura të parapara në Tabelën 2 do t'i paguhet përmbauesit privat, nga kreditori para realizimit të aktivitetit të përmbauesit, për t'u rimbursuar pastaj nga debitorit".

Me nenin 367 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të LPP është paraparë se, shkeljet disiplinore ndër të tjera munden të jenë: "nëse përmbauesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj; nëse

gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbaruesi privat nuk i përmbahet ligjit''.

Komisioni, pas vlerësimit të provave të shqyrtuara përmes leximit dhe marrjes në pyetje në këtë çështje disiplinore, në seancën për këshillim dhe votim me shumicë votash ka ardhë në përfundim se, përmbaruesja ka kryer shkelje disiplinore në këtë çështje përmbarimore, për shkak se gjatë ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore si mjete të përmbarimit nuk i është përmbajtur ligjit, rrjedhimisht ka ndërmarrë veprime përmbarimore jo në përputhje me dispozitat e nenit 10 par.1 dhe 2, nenit 13 par.1 dhe 2 të LPP dhe, nenit 4 par.1 të UA.MD.nr.06/14 për faktin se, së pari me rastin e daljes në teren ka ndërmarrë veprime përmbarimore në drejtim të regjistrimit dhe sekuestrimit të sendeve të debitorit me qëllim të realizimit të kërkesës së kreditorit të përmbarimit, edhe pse kreditori i përmbarimit në propozimin për përmbarim nuk ka kërkuar që përmbarimi të shtrihet edhe në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme por, ka kërkuar që kërkesa e tij të realizohet përmes sekuestrimit dhe kalimit të mjeteve nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë bankare të kreditorit të përmbarimit, së dyti sepse procedurën në këtë çështje përmbarimore e ka pezulluar në kundërshtim me nenin 13 par. 1 dh 2 të LPP dhe, nenin UA.MD.nr.06/14 me të cilat dispozita është paraparë se për veprimet përmbarimore të cilat parashihet të ndërmerren nga përmbaruesi privat, do t'i paguhen nga kreditori i përmbarimit para realizimit të aktivitetit të përmbaruesit, për t'u rimbursuar pastaj nga debitori i përmbarimit dhe, së treti për shkak se në procesverbalin e dt:05.03.2018, përmbaruesja në kundërshtim me nenin 136 të LPK lidhur me nenin 17, ka bërë një shënim shtesë në procesverbal pasi që është kthyer nga tereni në zyrat e punës, pasi që procesverbali ishte nënshkruar nga i autorizuari i kreditorit, personi i tretë vjehri i debitorit dhe nga përmbaruesja-zyrtari, si dhe të njëjtin nuk ka dëshmi se ju ka dorëzuar nga një kopje kreditorit të përmbarimit dhe debitorit të përmbarimit, e as personit të tretë i cili ka në këtë procesverbal ka pranuar t'a përmbushë detyrimin në vend të debitorit të përmbarimit, ashtu siç parashihet me dispozitat që kanë të bëjnë me komunikimin me palët në procedurë.

Komisioni, nga gjendja faktike e vërtetuar si më lart, ka vlerësuar se masa disiplinore gjobë në të holla në shumën prej 500.00€, është në harmoni me shkeljet e kryera disiplinore nga përmbaruesja private, ngase ka ndërmarrë veprime përmbarimore jo në përputhje me dispozitat e nenit 10 par.1 dhe 2, nenit 13 par.1 dhe 2 të LPP dhe, nenit 4 par.1 të UA.MD.nr.06/14 dhe, në kundërshtim edhe me nenin 136 të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, kur e ka pezulluar procedurën për shkak se kreditori i përmbarimit nuk ka paguar për veprimet përmbarimore, për faktin se nga shkresat e lëndës shihet se, për veprime të ndërmarra më heret edhe pse kreditori i përmbarimit nuk ka paguar, përmbaruesja ka ndërmarrë veprime përmbarimore, për të cilat veprime mjetet pastaj i ka inkasuar tek kur personi i tretë ka pranuar t'a përmbushë detyrimin në vend të debitorit të përmbarimit dhe, tek pasi ka inkasuar mjetet për veprimet e ndërmarra nuk ka pranuar më të ndërmarr asnjë veprim tjetër nëse nuk i paguhet taksa paraprakisht për veprimin e ardhshëm, ani pse nga procesverbali vërtetohet se personi i tretë ka pranuar t'a paguaj borxhin kryesor ndërsa, për pjesën në shumën prej 329.40€ ka deklaruar se do t'i paguaj brenda dhjetë (10) ditëve.

Komisioni, ka vlerësuar se masa disiplinore e shqiptuar është e mjaftueshme tani për tani, për shkak se deri më tani nuk ka gjetur se përmbarueses i është shqiptuar ndonjë masë tjetër disiplinore dhe, se do kjo masë do ti shërbej përmbarueses si organ përmbarues në këtë çështje përmbarimore, si dhe përmbarueseve të tjerë që t'u përmbahen me përpikëri dispozitave ligjore gjatë zbatimit të përmbarimit në secilën çështje përmbarimore që do të paraqitet para tyre për

përmbarrim dhe, që të jenë më të kujdesshëm, ashtu që përmbarrimi të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundshme për debitorët e përmbarrimit.

Bazuar në nenin 10 par.1 dhe 2, 13 par.1 dhe 2, nenit 341 par.1, nënpar.1.1 dhe 1.2, dhe nenit 367 par.1, nënpar.1.1, 1.2, 1.7 dhe 1.10 të LPP, nenit 4 par.1 të UA.MD.nr.06/14 dhe, nenit 136 të LPK lidhur me nenin 17 të LPP dhe, mbi bazën e asaj që është thënë më lart, komisioni vendosi si në dispozitiv.

**Komisioni Disiplinor për Përmbarruesit Privat
Nr.03/2019; dt:03.04.2019**

**Kryetari i Komisionit Disiplinor:
Alajdin Tërshnjaku**



Këshillë juridike: Vendimi i Komisionit Disiplinor për Përmbarruesit Privat është përfundimtar. Kundër vendimit të komisionit disiplinor mund të ngritet konflikti administrativ bazuar në par.5 të nenit 374 të LPP-së.